




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TE KOMUNES SE JUNIKUT
PER VITIN 2025-2027

Dëgjimi i dytë buxhetor
PROCESVERBAL

Me datë 23.07.2024 duke filluar nga ora 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal u mbajt dëgjimi i dytë buxhetor i dedikuar për gratë e Komunës së Junikut. Takimin e hapi dhe moderoi z.Arten Hamza - Zyrtar Kryesor Financiar njëherit Kryesues i Grupit Punues i zgjedhur me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu.

z.Arten Hamza përshëndeti dhe falënderoi të pranishmet për pjesëmarrje, ai tha se numri i pjesëmarrësve shihet që është i vogël edhe pse njoftimi ishte publikuar para dy javësh, por mund të kenë ndikuar temperaturat e larta dhe angazhimet e tjera të qytetarëve. Para se të vazhdoj me prezantim të buxhetit i kaloj fjalën drejtoreshës për Buxhet dhe Financa znj.Vjollca Qestaj.

Znj.Vjollca Qestaj përshëndeti gratë e pranishme dhe i falenderoj që gjetën kohën të vinin në dëgjimin e dytë vetëm për gratë e Komunës së Junikut ku si qëllim kryesor është informimi rreth buxhetit të komunës tonë dhe marrja e propozimeve nga ana e qytetarëve për shfrytëzimin sa me efikas të buxhetit për periudhën 2025-2027.

z. Arten Hamza tregoj që me vendimin e kryetarit z.Ruzhdi Shehu është formuar grupi punues për planifikim të buxhetit ku shumica jeni prezent. Në qershor e kemi mbajtur dëgjimin e parë për kornizën afatmesme buxhetor dhe ky është dëgjimi i dytë i dedikuar vetëm për gra të Komunës së Junikut. Ne planifikojmë që edhe në muajin Gusht dhe Shtator ti mbajm edhe dy dëgjime tjera. Lus të gjitha të pranishmet të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes dhe nëse kanë propozime mund ti shënojnë edhe me shkrim në listën e propozimeve për projektet që ju mendeni të futen në Korizëm Afatmesme Buxhetore, apo edhe në planifikimin e buxhetit për periudhën tre vjeçare 2025-2027, ku ne do ti evidentojm të gjitha kërkesat e juaja. Ne do ti publikojm të gjitha procesverbalet e dëgjimeve buxhetore në Webfaqen e Komunës dhe në fund të gjitha dëgjime do të hartojmë raportin e përgjithshëm të procesit të planifikimit të buxhetit dhe dëgjimeve publike. Unë kam përgatitur edhe një prezantim të shkurtër të buxhetit.

Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore burimet e financimit te Komunes se Junikut përfshin:

- Granti i përgjithshëm
- Grandi specifik për Arsim
- Grandi specifik për Shëndetësi
- Të hyrat Vetanake
- Donacionet

Buxheti për Komunën e Junikut parashihet të jetë në shumë prej **2,340,143.00** euro për vitin 2025.

- Grantet qeveritare: **2,135,201.00** euro
- Të Hyrat Vetanake: **204,942.00** euro

Sipas Qarkores 2025/01 Grantet qeveritare në krahasim me vitin 2024 kanë ndryshim pozitiv në vlerë prej 143,421.00 euro apo e shprehur në përqindje 7.20% .


Ndryshimi është në Grantin e përgjithshëm në vlerë prej 78,717.00 apo 7.13%, Granti specifik për Arsim në vlerë prej 34,294.00 apo 6.30%, Granti specifik per Shendetesi në vlerë prej 30,410.00 apo 8.86% krahasuar vlerën e granteve të vitit 2024 .


Të hyrat vetanake kanë zvogëlim në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 në vlerë prej - 3,114.00 apo -1.50% .

Burimet e financimit sipas viteve në Komunën e Junikut.

	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Ndryshimi	%	Buxheti 2026	Ndryshimi	%	Buxheti 2027	Ndryshimi	%
Total Buxheti	2,199,836	2,340,143	140,307	6.38	2,454,219	114,076	4.87	2,571,075	116,856	4.76
THV	208,056	204,942	(3,114)	(1.50)	222,358	17,416	8.50	240,063	17,705	7.96
Grantet Qeveritare	1,991,780	2,135,201	143,421	7.20	2,231,861	96,660	4.53	2,331,012	2,331,012	4.44
Granti i përgjithshëm	1,103,827	1,182,544	78,717	7.13	1,244,049	61,505	5.20	1,306,676	1,306,671	5.03
Granti i arsimit	544,726	579,020	34,294	6.30	596,390	17,370	3.00	614,282	614,279	3.00
Granti i shëndetësisë	343,227	373,637	30,410	8.86	391,422	17,785	4.76	410,054	410,049	4.76

Buxheti per vitin 2025 sipas burimeve te financimit







Planifikimi i shpenzimeve sipas viteve 2024 -2027

	2024	2025	2026	2027	2024/2025	2025/2026	2026/2027
Paga dhe mëditje	1,445,893.00	1,536,835	1,541,852	1,546,989	6.29	0.33	0.33
Mallra dhe shërbime	246,660.00	274,860	299,860	314,860	11.43	9.10	5.00
Shërbime komunale	38,500.00	42,950	44,950	45,950	11.56	4.66	2.22
Subvencione	62,000.00	70,000	75,000	80,000	12.90	7.14	6.67
Investimet	406,784.00	415,498	492,557	583,276	2.14	18.55	18.42
Totali i buxhetit	2,199,837.00	2,340,143.00	2,454,219.00	2,571,075.00	6.38	4.87	4.76

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



= Paraqitja grafike pjesëmarrja sipas kategorive ekonomike në vitin 2025



Nëse dikush prej qytetarëve keni nevojë për sqarime rreth buxhetit apo procedurave të planifikimit të buxhetit, apo edhe propozime mund ti shprehni edhe me fjalë. Kërkesë e juaja do të merren parasysh dhe do shënohen në procesverbal si dhe në raportin përfundimtar, dhe përgjigjet rreth atyre propozimeve mund ti merrni përmes dëgjimeve tjera publike apo edhe nga webfaqja e komunës. Ne kemi marr propozime të shumta edhe nga dëgjimi i parë buxhetor por është mirë që shikohen edhe interesat e grave, prandaj ju kaloj fjalën juve që të shprehni propozimet e juaja.

Meqenëse asnjë qytetare nuk mori fjalën z.Arten Hamza tha që propozimet e cekura në listën e propozimeve do ti shënojmë në procesverbal dhe raport.

Ai falënderoj të gjitha për pjesëmarrje dhe mbylli takimin.

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 15 qytetarë prej tyre 10 të gjinisë femërore. Prezent ishin edhe konsulenti nga DEMOS z.Ibrahim Kryeziu si dhe dy përfaqësues nga OSBE.

Tek lista e propozimeve qytetarët shprehën idetë e tyre të cilat ishin:

- Ndërtimi i kanalit të ujërave të zeza në lagjen Pepsh, rruga e Gështenjave deri tek shtëpitë e Binak, Malë dhe Ali Pepshi, në gjatësi 250m, të cilat akoma nuk kanë kanalizim të ujërave të zeza. – Klodiana Pepshi
- Rregullim i hapësirave publike në Lagjen Miroc dhe Malok – Këndi i Lodrave. – Iliriana Isufaj.

Procesverbalmbajtëse:

Ariola Krasniqi